

**ENTI RREGULLATOR I UJIT**



## **SHOQËRIA RAJONALE UK FIER**

**ANALIZA E HUMBJEVE TË UJIT PËR VITIN 2022**

**Tiranë, 2023**

## **Bilanci i Ujit**

### **Analiza e Humbjeve të Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Fier**

#### ***I. Të Përgjithshëm mbi Hartimin e Bilancit të Ujit***

ERRU harton çdo vit Raportin e Bilancit të Ujit për shoqëritë që operojnë në Sektorin Ujësjellës-Kanalizime. Ky raport merr një rëndësi të veçantë për një menaxhim racional të sektorit sepse trajton në mënyrë të veçantë treguesin e Ujit Pa të Ardhura, pra humbjet e ujit. Treguesi UPA lidhet ngushtësisht më cilësinë e shërbimeve që shoqëritë i ofrojnë konsumatorëve si edhe më qëndrueshmërinë financiare të tyre.

Organizimi i ri i shoqërive, në 15 shoqëri rajonale në sektorin UK, ka sjellë nevojën për një strukturim të ri të analizës mbi UPA dhe “Bilancin e Ujit” në tërësi. Analiza e humbjeve të ujit për çdo shoqëri rajonale kryhet duke analizuar fillimisht Bilancin e Ujit më vehte për çdo njësi (ish shoqëri UK) që tashmë është nën administrimin e shoqërisë rajonale të krijuar dhe më pas analiza bëhet në mënyrë të integruar për shoqërinë rajonale në tërësi. Kjo qasje mundëson vënien në pah të problematikave individuale të çdo njësie të cilat duhet të kihen parasysh në të ardhmen për zgjidhjen apo përmirësimin e tyre.

Kjo analizë i vjen në ndihmë çdo shoqëri rajonale duke i mundësuar asaj që nëpërmjet analizës së komponentëve përbërës të Bilancit të Ujit, për çdo njësi dhe në tërësinë e shoqërisë rajonale, të njihet në mënyrë analitike më nivelin e humbjeve (UPA), të nën komponentëve të saj, arsyet e veçanta të nivelit të lartë të humbjeve të ujit, nevojën dhe mënyrën e monitorimit të humbjeve, problematikat e faturimit me matje dhe aforfe, si dhe rekomandimet që ERRU jep për çdo shoqëri UK për të realizuar përmirësimet e nevojshme në punën e tyre.

“Bilanci i Ujit” si një instrument mjaft i rëndësishëm në përmirësimin e treguesit kryesor të performancës UPA, duhet të hartohet më të dhëna sa më të sakta pasi hapat që do të ndërmerren për reduktimin e tij lidhen ngushtësisht edhe më qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë.

Si model i hartimit të Bilancit të Ujit do të përdoret ai i IWA (Shoqërisë Ndërkombëtare të Shoqërive të Ujësjellësve).

Duke patur parasysh gjendjen teknike të sistemeve të furnizimit më ujë si mungesën e matësve në burim, mos organizim të rrjeteve shpërndarëse bazuar në konceptin e Zonave më Matje të Pavarura (DMA-të), mangësitë në mjetet dhe metodat e monitorimit të konsumit, është vendosur që si metodologji e llogaritjes së nën komponentëve të Bilancit të Ujit të përdoret ajo nga “lart-poshtë” (top-down), ku fokusi kryesor në llogaritjen e humbjeve totale është përcaktimi i humbjeve të dukshme, dhe më tej përcaktohen ato reale.

#### ***II. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Fier***

Shoqëria rajonale UK Fier u krijua nga bashkimi i ish shoqërive UK ose Njësitë, përkatësisht UK Fier, Patos, Roskovec dhe Mallakastër.

Të dhëna të përgjithshme në lidhje me popullsinë e shërbyer, konsumin për banorë me matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit të Sh. R UK Fier jepen në tabelën 1.

**Nga të dhënat e Tabelës 1**, probleme të nën faturimit me matje nuk konstatohet në asnjë prej njësive ndërkohë që probleme me faturimin aforfe rezultuan në të gjitha njësitë e Sh. R Fier.

Njësitë Fier, Patos dhe Roskovec duhet të analizojnë arsyet e mbi faturimit aforfe sepse referuar VKM nr.102, datë 16.03.1992, duhet të jetë 150 litra/banor në ditë.

Njësia Mallakastër(120 litra/banor në ditë) duhet të kryej verifikimet e duhura mbi numrin e lidhjeve nëse ato përfshijnë edhe klientët jo aktive. Referuar po këtij vendimi, ish shoqëritë UK Fier (234.6 litra/ ditë për banorë), Patos (288.8 litra/ ditë për banorë), dhe Roskovec (301.3 litra/ ditë për banorë) duhet të analizojnë me kujdes të dhënat mbi volumet e faturuara dhe numrin e klientëve të faturuar aforfe, për të gjetur dhe arsyet e këtij mbi faturimi.

**Tabela Nr. 1 Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe**

Shoqëria Rajonale UK Fier	Popullsia* e Shërbyer	Konsumi Total (në m3)	Konsumi i Matur (në m3)	Konsumi Pamatur (në m3)	Lidhjet me matës	Lidhjet pa matës	Konsumi (l/ditë, banor)		
							Konsumi i matur	Konsumi aforfe	Konsumi Total
Fier	73,038	3,950,000	2,244,000	1,706,000	24,166	9,066	115.8	234.6	148.2
Patos	13,833	684,100	317,900	366,200	4312	1,446	84.1	288.8	135.5
Roskovec	6,988	307,300	285,500	21,800	3,048	89	115.2	301.3	120.5
Mallakastër	17,032	577,800	316,600	261,200	3,515	1,895	78.4	120.0	92.9
<b>Shuma</b>	<b>110,891</b>	<b>5,519,200</b>	<b>3,164,000</b>	<b>2,355,200</b>	<b>35,041</b>	<b>12,496</b>	<b>106.0</b>	<b>221.4</b>	<b>136.4</b>

Referuar tendencës së rritjes së vazhdueshme të kërkesës për ujë, si dhe problematikat e pritshme të rezervave ujore për shkak të ndryshimeve klimatike duhet bërë një vlerësim i këtyre rezervave në krahasim me plotësimin e kërkesës për ujë, të paktën asaj aktuale. Për këtë qëllim në tabelën 2, krahas volumit të ujit të prodhuar dhe konsumit për popullsinë e shërbyer jepen dhe burimet ujore respektive dhe kapacitetet e tyre.

**Tabela 2.** Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve

Sh. Rajonale Fier	Popullsia* e Shërbyer	Uji i Prodhuar që futet në sistem në m3)	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe (l/ditë, banor)	Popullsia e Regjistruar në Zonën e Shërbimit	Burimi dhe Kapaciteti i Tij (në m3/vit)	Sasia e Disponueshme e Ujit (l/ditë, banor)	Diferenca në Plotësimin e Kërkesës (l/ditë, banor)
Fier	73,038	16,128,000	148.2	115,595	16,895,000	400	+252.3
Patos	13,833	2,223,000	135.5	18,959	2,609,000	377	+241.5
Roskovec	6,988	857,801	120.5	13,654	5,961,600	1,196	+1,075.7
Mallakastër	17,032	1,580,000	92.9	21,824	22,587,000	2,836	+2,742.6
<b>UK Fier Rajonale</b>	<b>110,891</b>	<b>20,788,801</b>	<b>136.4</b>	<b>170032</b>	<b>48,053,000</b>	<b>774</b>	<b>+637.9</b>

\* Popullsia në juridiksion u korrigjua duke u bazuar në të dhënat e INSTAT-it të publikuara në rang qarku në Janar të vitit 2023 ndërsa për popullsinë në shërbim si bazë për logaritje shërbeu mbulimi me shërbim i raportuar nga vetë shoqëritë UK.

Nga tabela 2 shihet se të gjitha njësitë e shoqërisë rajonale UK Fier kanë burime të mjaftueshme ujore për plotësimin e kërkesës për ujë në zonën e saj të shërbimit. Në fokusin e shoqërisë rajonale duhet të

jetë mbrojtja e burimeve nëpërmjet shfrytëzimit me efikasitet të burimeve ujore të disponueshme, duke u bazuar në prodhimin sipas kërkesës për ujë si dhe reduktimin e humbjeve të ujit në të gjitha njësitë përbërëse për të arritur dhe qëllimin final “kohëzgjatje të furnizimit me ujë më 24/7” për çdo njësi furnizimi.

## II.1 UPA për Ish Shoqërinë UK Fier

Gjatë vitit 2022, ish shoqëria UK Fier ka prodhuar 16,128,000 m<sup>3</sup> ujë prej cilës **84.5% e tij matet**. Raportohen 36,993 lidhje uji ndërsa shërbimi me furnizimin me ujë ofrohet për rreth 63.2% të popullsisë në juridiksion.

“UPA” rezulton në nivelin **70.83%**. Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë për qytetin e Fierit është i organizuar në zona të pavarura me matje (DMA), për rrjedhojë monitorimi i humbjeve bëhet i detajuar sipas DMA-ve, ndërsa në zonat rurale nuk janë të organizuar në zona të pavarura me matje (DMA). Kjo gjendje vështirëson monitorimin efikas në total të humbjeve në zonën e shërbimit për të ndërtuar më tej strategjinë për zvogëlimin e humbjeve me orientim prioriteti në DMA-të me problematike.

Në tabelën 3 paraqitet bilanci i ujit si dhe komponentët përbërës të tij për ish shoqërinë UK Fier.

**Tabela 3.** Bilancit i Ujit për Ish Shoqërinë Fier- Viti 2022.

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m <sup>3</sup> )	Ndaj Ujit të Prodhuar (në %)
<b>Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem</b>	<b>16,128,000</b>	<b>100.00%</b>
Konsumi i ujit të faturuar i matur	2,810,000	17.42%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	1,895,000	11.75%
<b>Faturimi Total</b>	<b>4,705,000</b>	<b>29.17%</b>
<b>Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar</b>	<b>72,189</b>	<b>0.45%</b>
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	1,500,000	9.30%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	3,078,351	19.09%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	802,105	4.97%
<b>Humbjet e Dukshme (Administrative)</b>	<b>5,380,456</b>	<b>33.36%</b>
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	900,000	5.58%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	600,000	3.72%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit	550,000	3.41%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	3,800,000	23.56%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjetës	120,355	0.75%
<b>Humbjet Reale (Teknike)</b>	<b>5,970,355</b>	<b>37.02%</b>
<b>Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)</b>	<b>11,350,811</b>	<b>70.38%</b>
<b>UJI PA TË ARDHURA</b>	<b>11,423,000</b>	<b>70.83%</b>

### **Komente :**

- UPA në nivelin 70.83% të prodhimit vjetor, konsiderohet në nivele mjaft të larta dhe i papranueshëm.
- Volumi i ujit të prodhuar raportohet i matur në nivelin 84.5%.
- Niveli i humbjeve reale në rrjetin e shpërndarjes (23.56%) konsiderohet mjaft i lartë. Për këtë shoqëria duhet të verifikojë nëse ekzistojnë të regjistruara në evidenca të cilat vërtetojnë çarje mjaft të shpeshta të linjave të shpërndarjes. Humbjet nga rrjedhjet në stacione pompimi, burim dhe depot e ujit në të cilat humbjet rezultojnë mbi normat e lejuara.
- Konsumi total faturohet me matje në nivelin 59.7% ndërsa 74% e konsumatorëve janë të pajisur me aparate ujëmatës individuale.
- Humbjet administrative (33.36%) raportohen në nivele të larta dhe të pa pranueshme, ato shkaktohen nga lidhjet e paligjshme në transmetim në nivelin 9.3% e prodhimit ndërsa në shpërndarje 19.09% e tij.

### **Rekomandime:**

- *Ti kushtohet kujdes dhe rëndësi e veçantë volumit të ujit të prodhuar që përcaktohet më vlerësim, për t'ju afruar sa më shumë realitetit deri sa të mundësohet prodhimi i matur në nivelin 100%. Shoqëria duhet të marrë masa urgjentë për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre, në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.*
- *Në lidhje me përqindjen e lartë të mundshme të lidhjeve të paligjshme, Njësia duhet të ndërmarrë plan veprimi për të përcaktuar sa më saktësisht bazën e klientëve, që krahas verifikimeve në terren (taks-forcë) të krahasohet edhe me bazën e klientëve të OSHEE-së, si edhe me verifikime në vend për anashkalim të ujëmatësit me lidhje dytësore.*
- *Të thellohet në analizën për të përcaktuar se ku ekziston saktësisht problematika më ujin e faturoar aforfe i cili rezultoi në nivele mjaft të larta (234.6 l/banorë në ditë), si kontroll i punës së lexuesve të matësave, për të verifikuar sa klientë faturohen aforfe dhe se sa është numri i banorëve për çdo lidhje bazuar në certifikatën familjare të vitit aktual.*
- *Për humbjet reale të larta në linjat e transmetimit dhe rrjetin shpërndarës, nëse janë probleme evidente të gjendjes së keqe fizike të tyre, urgjentisht të planifikohen fonde nga qeveria qendrore ose me fondet e veta për riparimin e tyre.*
- *Shoqëria të ketë si prioritet edhe organizimin e rrjeteve të shpërndarjes në DMA për zonat rurale, për të diagnostikuar DMA-te ku janë problemet më të mëdha me humbjet.*

## **II.2 UPA për Ish Shoqërinë UK Patos**

Shërbimi i furnizimit me ujë në Njësinë Administrative Patos i ofrohet 73% të popullsisë në juridiksion. Prodhimi vjetor prej 2,223,000 m<sup>3</sup> ujë është **100% i vlerësuar** pasi mungojnë matësa në burim.

Numri i lidhjeve me ujin raportohet 6,091 lidhje ku 74.1% e tyre janë të pajisur me ujëmatës ndërsa pjesa tjetër faturohet aforfe.

Faturimi i realizuar rezulton në nivelin 40.26% të prodhimit.

**“Uji Pa të Ardhura” është në nivelin 59.74%.**

Monitorimi i humbjeve në rrjetin shpërndarës nuk bëhet në baze të DMA-ve.

Për vitin 2022, njësia Patos nuk ka dorëzuar formatin mbi bilancin e ujit ndonëse është komunikuar zyrtarisht. Nevoja për trajnim mbi humbjet për stafin teknik të njësisë është e domosdoshme.

**Në Tabelën 4** paraqiten komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për ish shoqërinë UK Patos.

**Tabela 4.** Bilanci i Ujit për Ish Shoqërinë UK Patos – Viti 2022

Emërtimi	Viti 2022	Ndaj Ujit të Prodhuar (në %)
<b>Volumi i ujit të prodhuar që futët në sistem</b>	<b>2,223,000</b>	<b>100.00%</b>
Konsumi i ujit të faturuar i matur	511,000	22.99%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	384,000	17.27%
<b>Faturimi Total</b>	<b>895,000</b>	<b>40.26%</b>
<b>Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar</b>	<b>2,000</b>	<b>0.09%</b>
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	100,000	4.50%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	111,000	4.99%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	315,000	14.17%
<b>Humbjet e Dukshme (Administrative)</b>	<b>526,000</b>	<b>23.66%</b>
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	120,000	5.40%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	40,000	1.80%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit	35,000	1.57%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	600,000	26.99%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjellësit	5,000	0.22%
<b>Humbjet Reale (Teknike)</b>	<b>800,000</b>	<b>35.99%</b>
<b>Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)</b>	<b>1,326,000</b>	<b>59.65%</b>
<b>UJI PA TË ARDHURA</b>	<b>1,328,000</b>	<b>59.74%</b>

**Komente :**

- UPA prej 59,74% konsiderohet në nivele të pakënaqshme.
- Pasaktësia e mundshme gjatë përlllogaritjes të sasisë së ujit të prodhuar me vlerësim (për 100% l vlerësuar), mund të jetë shkak kryesor i diferencës mjaft të madhe ndërmjet volumit të ujit të prodhuar ndaj atij të faturuar.
- Humbjet administrative në nivelin (23.66%), shkaktohen kryesisht nga lidhjet e paligjshme në rrjetet e transmetimit (4.5 %), shpërndarje (4.99%) dhe nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim (14.17%). Këto humbje konsiderohen mjaft të larta dhe të papranueshme.

- Humbjet teknike në nivelin (35.99%) konsiderohen në kufijtë e niveleve të lartë e të pa pranueshme dhe shkaktohen kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës (26.99%). Shoqëria duhet të analizojë situatën në terren për numrin e madh të defekteve dhe mundësinë e uljes së humbjeve të shkaktuara prej tyre.

#### **Rekomandime:**

- *Duke patur parasysh që asnjë burim i shfrytëzueshëm nuk është i pajisur me ujëmatës, nevoja për investime në ujëmatës në prodhim është e domosdoshme dhe imediate. Shoqëria duhet të marrë masa urgjentë për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.*
- *Në lidhje me përqindjen e lartë të mundshme të lidhjeve të paligjshme, Njësia duhet të ndër marrë plan veprimi për të përcaktuar sa më saktësisht bazën e klientëve, që krahas verifikimeve në terren (taks-force) të krahasohet edhe me bazën e klientëve të OSHEE-së, si edhe me verifikime në vend për anashkalim të ujëmatësit me lidhje dytësorë.*
- *Për humbjet reale të larta në linjat e transmetimit dhe rrjetin shpërndarës, të verifikohet shkaku i tyre nëse janë probleme evidentë të gjendjes së keqe fizike të tyre. Për këtë urgjentisht të planifikohen fonde nga qeveria qendrore ose me fondet e veta për riparimin e tyre.*
- *Shoqëria të këtë si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA të cilat mundësojnë monitorimin më të mirë të humbjeve dhe diagnostikimin ku janë problemet me të mëdha me humbjet, në bazë të të cilave do të hartohen planet e masave për zvogëlimin e tyre.*

### **II.3 UPA për Ish Shoqërinë UK Roskovec**

Shërbimi i furnizimit me ujë në Njësinë Administrative Roskovec ofrohet për 51.2% të popullsisë në juridiksion. Prodhimi vjetor prej 857,801 m3 ujë është **100% i vlerësuar** sepse mungojnë matësat në burime.

Nga raportimi i të dhënave, faturimi rezulton 38.28% e prodhimit.

#### **“Uji Pa të Ardhura” në nivelin 61.72%.**

Ish shoqëria UK Roskovec ka në administrim 3,298 lidhje me ujin, ku 97% e tyre faturohen me matje dhe pjesa e tjetër aforfe.

Monitorimi i humbjeve në rrjetin shpërndarës nuk bëhet në bazë të DMA-ve, nevoja për trajnim mbi humbjet e ujit është e domosdoshme për stafin teknik.

**Në Tabelën 5** paraqiten komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për ish shoqërinë UK Roskovec.

**Tabela 5.** Bilanci i Ujit për Ish Shoqërinë UK Roskovec – Viti 2022

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m3)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në %)
<b>Volumi i ujit të prodhuar që futët në sistem</b>	<b>857,801</b>	<b>100.00%</b>
Konsumi i ujit të faturuar i matur	297,075	34.63%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	31,280	3.65%
<b>Faturimi Total</b>	<b>328,355</b>	<b>38.28%</b>
<b>Konsumi i Autorizuar i Pa Faturuar</b>	<b>26,885</b>	<b>3.13%</b>
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	80,065	9.33%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	177,483	20.69%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	61,766	7.20%
<b>Humbjet e Dukshme (Administrative)</b>	<b>319,314</b>	<b>37.22%</b>
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	33,355	3.89%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	22,766	2.65%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit	8,471	0.99%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	116,478	13.58%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjellësit	2,177	0.25%
<b>Humbjet Reale (Teknike)</b>	<b>183,247</b>	<b>21.36%</b>
<b>Humbjet Totale (Reale dhe të Dukshme)</b>	<b>502,561</b>	<b>58.59%</b>
<b>UJI PA TË ARDHURA</b>	<b>529,446</b>	<b>61.72%</b>

**Komente :**

- UPA rezulton në nivelin 61.72% të prodhimit vjetor dhe konsiderohet në nivele shumë të larta e të papranueshme.
- Format i bilancit të ujit plotësohet me mjaft vështirësi nga stafi. Shihet si domosdoshmëri nevoja për trajnim të stafit mbi humbjet e ujit dhe monitorimin e tyre.
- Pasaktësia e mundshme në llogaritjen e sasisë së ujit të prodhuar 100% me vlerësim (jo me matje), vështirësitë në hartimin e bilancit të ujit, si dhe mungesa e DMA-ve e bëjnë jo të besueshme vërtetësinë e vlerës absolute të volumit të ujit të prodhuar e të treguesit UPA.
- Humbjet teknike në nivelin (21.36% ) raportohen 3.89% nga rrjedhjet në linjën e transmetimit dhe 13.58 % në rrjetin shpërndarës duken të jenë nën nivelet e pranuar për projektim dhe që duhet të verifikohet në terren vërtetësia e tyre.
- Humbjet administrative (37.22%) raportohen në nivele të larta dhe të pa pranueshme, ato shkaktohen nga lidhjet e paligjshme në transmetim në nivelin (9.33%) dhe në shpërndarje (20.69%), gjithashtu në nivele të larta (7.20%) rezultojnë dhe humbjet gjatë vlerësimit të volumeve të prodhuara, të faturuara, nën faturime etj.
- Konsumi total (38.28%) faturohet me matje në nivelin 90.5% ndërsa 97% e konsumatorëve janë të pajisur me aparate ujëmatës individuale.



### **Rekomandime:**

- *Duke patur parasysh që asnjë burim furnizimi me ujë nuk është i pajisur me ujëmatës nevoja për investime në ujëmatës në prodhim është e domosdoshme dhe imediatë, shoqëria duhet të marrë masa urgjentë për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre, në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.*
- *Në lidhje me përqindjen e lartë të mundshme të lidhjeve të paligjshme, Njësia duhet të ndër marrë plan veprimi për të përcaktuar sa më saktësisht bazën e klientëve, që krahas verifikimeve në terren (taks forcë) të krahasohet edhe me bazën e klientëve të OSHEE-së, si edhe me verifikime në vend për anash kalim të ujëmatësit me lidhje dytësore.*
- *Të thellohet në analizën për të përcaktuar se ku ekziston saktësisht problematika më ujin e faturuar aforfe i cili rezultoi 301.3 l/banorë në ditë, ndërkohë që duhet të jetë 150 litra/banor, ditë sipas VKM nr.102, datë 16.03.1992, si dhe të kontrollohet besueshmëria e punës së lexuesve të matësive, për të verifikuar sa klientë faturohen aforfe dhe se sa është numri i banorëve për çdo lidhje bazuar në certifikatën familjare të vitit aktual.*
- *Duke patur parasysh mangësitë dhe vështirësitë në raportimet e vlerave të Bilancit të ujit që ka demonstruar stafi i shoqërisë, është i domosdoshëm trajnimi i stafit (sipas programeve të trajnimit të SHUKALB) si dhe caktimi i një personi përgjegjës për monitorimin e humbjeve, saktësimin e të dhënave si dhe hartimin e bilancit të ujit për gjatë gjithë muajve të vitit.*
- *Shoqëria të shoh si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA të cilat mundësojnë monitorimin me të mirë të humbjeve, për të diagnostikuar ku janë problemet më të mëdha me humbjet, në bazë të të cilave do të hartohen planet e masave për zvogëlimin e tyre.*

#### **II.4 UPA për Ish Shoqërinë UK Mallakastër**

Në Njësinë Administrative Mallakastër shërbimi i furnizimit me ujë ofrohet për rreth 78 % të popullsisë në juridiksion. Prodhimi vjetor raportohet në sasinë 1,580,000 m<sup>3</sup>/vit në total nga e cila **72.6% e sasisë se prodhuar vlerësohet**, ndërsa diferenca prej 27.4% e prodhimit matet.

**Treguesi i UPA rezulton në nivelin 59.30%.** Konsumi i Autorizuar i Faturuar raportohet në nivelin 40.70 % ndërsa Konsumi i Autorizuar i pa Faturuar në nivelin 2.18% e prodhimit, ndërkohë që Shoqëria duhet të konsumojë për nevojat e veta rreth 1% të ujit të prodhuar.

Numri total i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë raportohet 5,894 lidhje, nga të cilat 66.6% e tyre faturohet me matje ndërsa pjesa tjetër aforfe. Lidhjet e paligjshme raportohen të pranishme në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes.

**Në Tabelën 6** paraqitet Bilancit të Ujit dhe komponentët përbërës të tij për ish shoqërinë UK Mallakastër.

**Tabela 6.** Bilanci i Ujit për Ish Shoqërinë UK Mallakastër – Viti 2022

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m3)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në %)
<b>Volumi i ujit të prodhuar që futët në sistem</b>	<b>1,580,000</b>	<b>100.00%</b>
Konsumi i ujit të faturuar i matur	373,000	23.61%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	270,000	17.09%
<b>Faturimi Total</b>	<b>643,000</b>	<b>40.70%</b>
<b>Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar</b>	<b>34,500</b>	<b>2.18%</b>
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	107,490	6.80%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	62,200	3.94%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	242,450	15.34%
<b>Humbjet e Dukshme (Administrative)</b>	<b>412,140</b>	<b>26.08%</b>
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	108,060	6.84%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	38,500	2.44%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit	28,000	1.77%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	292,800	18.53%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjellësit	23,000	1.46%
<b>Humbjet Reale (Teknike)</b>	<b>490,360</b>	<b>31.04%</b>
<b>Humbjet Totale (Reale dhe të Dukshme)</b>	<b>902,500</b>	<b>57.12%</b>
<b>UJI PA TË ARDHURA</b>	<b>937,000</b>	<b>59.30%</b>

**Komente :**

- UPA (59.30 %) rezulton në nivele të larta e të papranueshme.
- Vetëm 65 % e konsumatorëve familjare janë të pajisur me matës, pjesa tjetër faturohet aforfe.
- Prodhimi vjetor matet vetëm për 27.4 % të sasisë së ujit që hyn në sistem, pjesa tjetër prej 72.6 % e sasisë së prodhuar vlerësohet.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo në zona të ndara me matje (DMA).
- Humbjet teknike (31.04%) përbehen 6.84% nga rrjedhjet në linjat e transmetimit dhe 18.53% në rrjetin shpërndarës që konsiderohen në nivele të pa pranueshme.
- Humbjet administrative (26.08%) raportohen në nivele të larta nga lidhjet e paligjshme në transmetim në nivelin (6.80%) e prodhimit. Gjithashtu në nivele të larta (15.34 %) konsiderohen dhe humbjet gjatë vlerësimit të volumeve të prodhuara, të faturuara, nën faturime që kërkojnë verifikime në terren.
- Konsumi total faturohet me matje në nivelin 58% ndërsa 66.6% e konsumatorëve janë të pajisur me aparate ujëmatës individuale.

### **Rekomandime:**

- Duke patur parasysh që 72.6% e sasisë së ujit të prodhuar vlerësohet, nevoja për investime në ujëmatës në prodhim është e domosdoshme dhe imediate, shoqëria duhet të marrë masa urgjente për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.
- Shoqëria duhet të gjejë fonde për të rritur përqindjen e konsumatorëve familjare me matës që ky tregues të jetë sa më afër nivelit 100%, për të mundësuar minimizimin e humbjeve të dukshme nga lidhjet e paligjshme.
- Për humbjet reale të larta në linjat e transmetimit dhe rrjetin shpërndarës, të verifikohet shkaku i tyre nëse janë probleme evidente të gjendjes së keqe fizike të tyre. Përkëtë urgjentisht të planifikohen fonde nga qeveria qendrore ose me fondet e veta për riparimin e tyre.
- Duke patur parasysh mangësitë dhe vështirësitë në raportimet e vlerave të Bilancit të ujit që ka demonstruar stafi i shoqërisë, është i domosdoshëm trajnimi i stafit (sipas programeve të trajnimit të SHUKALB), si dhe caktimi i një personi përgjegjës për monitorimin e humbjeve, saktësimin e të dhënave si dhe hartimin e bilancit të ujit për gjatë gjithë muajve të vitit sepse në përgjithësi të dhënat e raportuara duken jo të besueshme.
- Shoqëria të shoh si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA të cilat mundësojnë monitorimin më të mirë të humbjeve, për të diagnostikuar ku janë problemet më të mëdha me humbjet, në bazë të të cilave do të hartohen planet e masave për zvogëlimin e tyre.

### **III Përmbledhëse e UPA për Shoqërinë Rajonale UK Fier**

Shoqëria Rajonale UK Fier, e krijuar nga bashkimi i ish shoqërive UK Fier, Patos, Roskovec dhe Mallakastër, ka nën juridiksion 170,032 banorë. Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë realizohet vetëm për 110,891 banorë ose 65.2 % të popullsisë totale. Numri i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë raportohet 52,276 lidhje, nga të cilat 39,041 lidhje ose 74.7% e tyre janë të pajisur me aparate ujëmatës.

Prodhimi vjetor 20,788,801 m<sup>3</sup> **rezulton i matur në nivelin 67.7 %**, nevoja e aparateve ujëmatës në pikat prodhuese është për të gjitha burimet e shfrytëzueshme.

**“Uji Pa të Ardhura” rezultoi në nivelin 68.39%** të ujit që hyn në sistem, shoqëria faturon vetëm 6,571,355 m<sup>3</sup> ujë ose 31.61 % të prodhimit.

**Tabela 7** paraqet komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për vitin 2022, për Shoqërinë Rajonale UK Fier.

**Tabela 7.** Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Fier – Viti 2022.

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m3)	Ndaj Ujit të Prodhuar (në %)
<b>Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem</b>	<b>20,788,801</b>	<b>100.00%</b>
Konsumi i ujit të faturuar i matur	3,991,075	19.20%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	2,580,280	12.41%
<b>Faturimi Total</b>	<b>6,571,355</b>	<b>31.61%</b>
<b>Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar</b>	<b>135,574</b>	<b>0.65%</b>
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	1,787,555	8.60%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	3,429,034	16.49%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	1,421,321	6.84%
<b>Humbjet e Dukshme (Administrative)</b>	<b>6,637,910</b>	<b>31.93%</b>
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	1,161,415	5.59%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	701,266	3.37%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit	621,471	2.99%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	4,809,278	23.13%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjellësit	150,532	0.72%
<b>Humbjet Reale (Teknike)</b>	<b>7,443,962</b>	<b>35.81%</b>
<b>Humbjet Totale (Reale dhe të Dukshme)</b>	<b>14,081,872</b>	<b>67.74%</b>
<b>UJI PA TË ARDHURA</b>	<b>14,217,446</b>	<b>68.39%</b>

**Komente :**

- Treguesi UPA në nivelin 68.39% të prodhimit vjetor, konsiderohet shumë i lartë dhe që urgjentisht duhen marrë masa për përmirësimin e tij.
- Humbjet nga lidhjet e paligjshme në rrjetin e shpërndarjes (16.49%) dhe të transmetimit (8.60%) janë në nivele shumë të larta dhe që duhen verifikuar në terren për nivelin real të tyre.
- Në humbjet teknike, humbjet nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes prej 23.13% të prodhimit vjetor konsiderohen mjaft të larta për të cilat duhen dhënë argumente për justifikimin e tyre.
- Konsumatorët familjarë me matje përbëjnë rreth 73.7% të numrit total të konsumatorëve, që për një menaxhim korrekt të kërkesës për ujë kërkohet të jetë sa më afër nivelit 100% të matjes.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në zona të ndara me matje (DMA) në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë.
- Në përgjithësi hasen mjaft vështirësi nga stafet për monitorimin e humbjeve dhe hartimin e bilancit të ujit, kjo e konstatuar nga të gjitha njësitë që përbëjnë këtë shoqëri rajonale.

**Rekomandime:**

- Të bëhen përpjekje për sigurimin e fondeve për të projektuar dhe zbatuar sisteme DMA në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë që mundëson një monitorim, diagnostikim dhe marrjen e masave për uljen e humbjeve në sistemet e furnizimit me ujë, si dhe hartimin e një bilanci korrekt të ujit.

- Të trajnojnë vazhdimisht stafin teknik në programet kombëtare të humbjeve të ujit të organizuara nga SHUKALB dhe më gjerë, si dhe të caktojë një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara, për hartimin e bilancit të ujit për çdo DMA dhe për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë rajonale.
- Duke patur parasysh që jo të gjithë burimet e furnizimit me ujë nuk janë të pajisur me ujëmatës, nevoja për investime në ujëmatës në prodhim është e domosdoshme dhe imediatë. Shoqëria duhet të marrë masa urgjentë për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.
- Shoqëria duhet të gjejë fonde për të rritur përqindjen e konsumatorëve familjarë me matës që ky tregues të jetë sa me afër nivelit 100%, për të mundësuar një menaxhim racional të kërkesës për ujë, si dhe minimizimin e humbjeve të dukshme.
- Hartimi i një plan veprimi me prioritete instalimin e matësve në shtëpitë private dhe kryesisht në zonat rurale.
- Në lidhje me përqindjen e lartë të mundshme të lidhjeve të paligjshme, shoqëria duhet të ndërmarrë plan veprimi për të përcaktuar sa më saktësisht bazën e klientëve bazuar edhe në bazën e klientëve të OSHEE-së.
- Të ngrihet një Taks - Forcë e cila vazhdimisht e në bashkëpunim me degën e shitjes për të verifikuar në terren rastet e mundshme të anashkalimit të ujëmatësit me lidhje dytësore apo klientë të paregjistruar me kontratë me shoqërinë, si dhe të kontrollohet besueshmëria e punës së lexuesve të matësve dhe në përgjithësi për evidentimin e problematikës me ujin e nën faturuar.
- Të krijojë dhe të mirëmbajë të gjitha sistemet e informacionit, për të patur raportim të saktë dhe të besueshëm të të dhënave të kërkuara, në lidhje me bilancin e ujit dhe çdo informacioni tjetër që mund të kërkoet.
- Të planifikojë investime në ujëmatës për të gjithë kategoritë e konsumatorëve, për të patur konsum të matur për çdo lidhje uji që faturohet.
- Për lidhjet pa matës, në pamundësi për vendosjen e matësit, nëpërmjet faturuesve duhet të verifikohet numri i banorëve (certifikatë familjare) për çdo lidhje dhe më pas të faturohen sipas VKM nr.102, datë 16.03.1992.
- Problematika në disa raste nuk është e njëjtë për çdo njësi. Për këtë duhet ti referohet problematikës në bilancin përkatës të çdo Njësie të veçantë.
- Të rrisë bashkëpunimin me ERRU-në për të tejkaluar vështirësitë në hartimin e bilancit të ujit dhe të dorëzojë atë në kohë pranë ERRU-së. Bilanci i ujit duhet të dorëzohet çdo 6 muaj, vërtetësia dhe saktësia e të dhënave të bilancit do të vlerësohet nga ERRU si penalitet ose bonus për shoqërinë raportuese.